



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 176

Tiranë – E premte, 12 nëntor 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 672, datë 10.11.2021	Për dhënien e miratimit, për lidhjen e kontratës, për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, në funksion të planeve të përgjithshme vendore, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si shitës, dhe shoqërisë “ <i>Building Construction</i> ” sh.p.k., si blerës, për pasurinë shtetërore që ndodhet në Tiranë, zona kadastrale 8270, e cila prek pasuritë nr. 7/102, nr. 8/657 e nr. 8/682, me sipërfaqe 2137 m ²	15593
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 10.11.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 382, datë 27.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për veprimtarinë e standardizimit’”.....	15600
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 675, datë 10.11.2021	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin e Roskovecit”...	15602
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 676, datë 10.11.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 699, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘ <i>By-Pass</i> Vlorë’ (shtesa)”, të ndryshuar.....	15604
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 677, datë 10.11.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 600, datë 18.10.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rikualifikimi urban i shëtitores ‘Republika’, Patos’”.....	15606
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 678, datë 10.11.2021	Për hapjen e institucionit të arsimit të lartë, jopublik, Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë.....	15607
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 679, datë 10.11.2021	Për hapjen e institucionit të arsimit të lartë, jopublik, universiteti “ <i>Western Balkans</i> ”.....	15607
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 680, datë 10.11.2021	Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore.....	15608



VENDIM

Nr. 672, datë 10.11.2021

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT, PËR LIDHJEN E KONTRATËS, PËR KALIMIN E PRONËS SHTETËRORE NË PRONË PRIVATE, NË FUNKSION TË PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCave DHE EKONOMISË, SI SHITËS, DHE SHOQËRISË “*BUILDING CONSTRUCTION*” SHPK, SI BLERËS, PËR PASURINË SHTETËRORE QË NDODHET NË TIRANË, ZONA KADASTRALE 8270, E CILA PREK PASURITË NR. 7/102, NR. 8/657 E NR. 8/682, ME SIPËRFAQE 2137 m²

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 2, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 7, të vendimit nr. 807, datë 11.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të kushteve për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, në funksion të planeve të përgjithshme vendore”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës, për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, në funksion të planeve të përgjithshme vendore (leje zhvillimore), ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si shitës, dhe shoqërisë “*Building Construction*” sh.p.k., si blerës, për pasurinë shtetërore, që ndodhet në Tiranë, zona kadastrale 8270, e cila prek pasuritë nr. 7/102, me sipërfaqe 1316 m², nr. 8/682, me sipërfaqe 215 m², e nr. 8/657, me sipërfaqe 606 m², sipas planrilevimit dhe tekstit të projektkontratës, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. _____ rep.

Nr. _____ kol.

KONTRATË SHITJE ME KUSHT PËR KALIMIN E PRONËS SHTETËRORE (TRUALL) NË PRONË PRIVATE, NË FAVOR TË SHOQËRISË “*BUILDING CONSTRUCTION*” sh.p.k.

Lidhur sot më datë _____.2021 (dymijë e njëzet e një), përpara meje, Noterit _____, me seli në Tiranë, u paraqitën personalisht dhe më kërkuan hartimin e kësaj kontrate, për kalimin e pronës shtetërore (truall) në pronë private, palët si më poshtë:

Neni 1
Palët

Pala shitëse: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike Tiranë, përfaqësuar nga z. _____, lindur në _____, me detyrë drejtor, i identifikuar me anë të nr. personal _____;

Pala blerëse: Shoqëria “*Building Construction*” sh.p.k. me NUIS L11401034P, me seli në Tiranë, Rruga e Elbasanit, vila nr. 71, e përfaqësuar nga administratori z. _____, lindur me _____, në _____, banues në _____, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me anë të letërnjoftimit nr. personal _____.

Neni 2
Objekti i kontratës

Objekt i kësaj kontrate është shitja me kushtet sipas përcaktimeve në nenin 4, pika 4.3, e pronës shtetërore (truall), në funksion të planeve të



përgjithshme vendore (leje zhvillimore), me sipërfaqe **2137 m²**. Prona shtetërore (truall) ndodhet në Tiranë, zona kadastrale 8270 dhe prek pasuritë nr. 7/102, nr. 8/657 dhe nr. 8/682.

Këto pasuri shtetërore kufizohen sipas planit të rëlvimit dhe hartave treguese bashkëlidhur kësaj kontrate.

Neni 3 Çmimi i shitjes

3.1 Çmimi i shitjes së pasurisë shtetërore, që kalon në pronë private, është **143 112 753 lekë**. Kjo vlerë është paguar plotësisht nga pala blerëse për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike Tiranë, në llogarinë të “ardhura nga shitja-tokë, troje, terrene” me nr. 1161110, sipas kushteve të vendosura në autorizimin për kryerje pagese nr. _____ prot., datë _____.2021.

3.2 Pala shitëse deklaron se në favor të saj është derdhur e gjithë shuma e përcaktuar në pikën 3.1 të këtij neni, para kohës së përpilimit të kësaj kontrate, sipas mandat arkëtimit/njoftim debitimit, datë _____.2021, pranë _____ Bank.

Neni 4 Kushtet e shitjes

4.1 Pala blerëse ka plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara nga pala shitëse në autorizimin për kryerje pagese nr. _____ prot., datë _____.2021.

4.2 Blerësi gjykohet se ka njohuri të plota për pasurinë pronë shtetërore, e cila ndodhet në Tiranë, që kalon në pronë private, dhe nuk ka asnjë pretendim lidhur me të.

4.3 Momenti i kalimit të pronësisë së pronës shtetërore në pronë private do të lidhet me realizimin e projektit, në funksion të të cilit është kërkuar kalimi i pronës shtetërore në pronë private. Kontrata, pas nënshkrimit të saj, regjistrohet në zyrën përkatëse të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me shënimin përkatës.

4.4 Nëse miratimi i lejes për zhvillimin e projektit, në funksion të të cilit është kërkuar kalimi i pronës shtetërore në pronë private, nuk bëhet brenda 5 (pesë) viteve nga nënshkrimi i kontratës, atëherë kontrata zgjidhet dhe palët i kthejnë njëra-tjetrës çdo gjë që i kanë dhënë si pasojë e kësaj kontrate.

4.5 Çmimi i përfutur nga kalimi i sipërfaqeve të pronës shtetërore në pronë private, sipas këtij vendimi, kalon 100 për qind në buxhetin e shtetit.

Neni 5 Detyrimet e shitësit

5.1 Shitësi garanton se prona që kalon në pronë private është pasuri shtetërore, fakt të cilin e vërteton i gjithë dokumentacioni që është i depozituar në dosjen përkatëse pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike.

Neni 6 Të drejta dhe detyrime të blerësit

6.1 Blerësi ka pranuar kalimin e pronës shtetërore në pronë private, sipas kushteve të përcaktuara në autorizimin për kryerje pagese nr. _____ prot., datë _____.2021.

6.2 Blerësit i kalon e drejta e pronësisë mbi pronën shtetërore, pas lidhjes së kësaj kontrate shitjeje dhe regjistrimit të saj në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorinë Vendore Tiranë Jug, pasi të jetë plotësuar kushti sipas nenit 4, pika 4.3.

6.3 Blerësi merr përsipër për të paguar të gjitha shpenzimet për veprimet noteriale, si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me këtë akt, bazuar në nenin 708, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 7 Baza ligjore për lidhjen e kontratës

7.1 Neni 83, 705 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 9967, datë 24.7.2008, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, ‘Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve’, të ndryshuar”;

VKM-ja nr. 807, datë 11.12.2019, “Për përcaktimin e kritereve dhe të kushteve për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, në funksion të planeve të përgjithshëm vendore”.



Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje midis palëve për pikat e kësaj kontrate zgjidhet me mirëkuptim. Në rast të kundërt palët i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 9

Pjesët përbërëse të kontratës

9.1 Pjesë e kësaj kontrate janë: autorizimi për kryerje pagese nr. _____ prot., datë _____.2021, lëshuar nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike Tiranë; kartelat e pasurisë së paluajtshme me HTR, për sipërfaqen pronë shtetërore që kalon në pronë private; planvendosja e sipërfaqes pronë shtetërore (plan rievimi); mandat-pagesa e cituar në nenin 3, pika 3.2, të kësaj kontrate; ekstrakti i regjistrimit tregtar.

Neni 10

Dispozita përfundimtare

10.1 Kjo kontratë është përpiluar në 4 (katër) kopje, me vlerë të njëjtë, dhe përbëhet nga 3 (tre) faqe secila, ku një kopje qëndron pranë kësaj zyre noteriale, një kopje i jepet blerësit, një kopje i dërgohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorisë Vendore Tiranë Jug, një kopje i jepet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike.

10.2 Kontrata, pasi lexohet nga palët, kuptohet përmbajtja e saj, është e njëjtë me vullnetin e tyre dhe nënshkruhet pa vërejtje para noterit.

10.3 Për sa më sipër, unë Noteri, pasi konstatova se akti i mësipërm është në pajtim të plotë me vullnetin e palëve dhe me ligjin, e vërtetoj atë rregullisht.

Neni 11

Regjistrimi në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës

11.1 Regjistrimi i kësaj kontrate shitje në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorinë Vendore Tiranë Jug, do të bëhet nga blerësi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të saj. Në të kundërt, për çdo ditë vonese, në bazë të ligjit nr. 111/2018, datë 7.2.2019, “Për kadastrën”, detyrohet të paguajë një tarifë shtesë gjobe konform rregullave përkatëse.

PALËT KONTRAKTUESE

PALA SHITËSE
Ministria e Financave
dhe Ekonomisë
Drejtoria e Drejtimit të
Pronës Publike

PALA BLERËSE
Shoqëria “*Building
Construction*” sh.p.k.
Administrator


NOTERI



PLAN

Shk:

	Siperfaqe Totale e pasurise 7/102 =2400.0m2
	Siperfaqe shtet per privatizim =1316.0m2
	Siperfaqe e pjeses se mbetur =1084.0m2

	Siperfaqe Totale e pasurise 8/682= 314.0m2
	Siperfaqe shtet per privatizim = 215.0m2
	Siperfaqe e pjeses se mbetur = 99.0m2

	Siperfaqe Totale e pasurise 8/657=1826.0m2
	Siperfaqe shtet per privatizim = 606.0m2
	Siperfaqe e pjeses se mbetur =1220.0m2






RILEVIMI

alla 1:1000



Pasurite te percaktuara ne lejen Zhvillimore
dhe me kontrate sipermarje.







Per Prefekturën
e Qarkut Tiranë

Alfred Skopi

Per ASHK Tiranë

A2B1 B1TR1

Per Ministrinë e Financave
Drejtoria e pronave Publike

NURI SOPA.17

ATITI

STUDIO MAPS
PROJEKTI
INXHIKIM
ARKITETURORE, QENDRORE
— Liç. N.6822 —
TIRANË - SHQIPËRI

12/ 2020

"BUILDING CONSTRUCTION"
NIPT. L11401034P

Zmer Memet



VENDIM

Nr. 673, datë 10.11.2021

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 382, DATË 27.6.2018,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
‘PËR VEPRIMTARINË E
STANDARDIZIMIT’”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 8, të ligjit nr. 9870, datë 4.2.2008, “Për standardizimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren bashkëlidhur vendimit nr. 382, datë 27.6.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun I, “Dispozita të përgjithshme”, bëhen shtesat dhe një ndryshim, si më poshtë vijon:

a) në fund të pikës 1, “Qëllimi”, shtohen fjalët “... dhe pjesëmarrjen e palëve të interesit në proceset e standardizimit.”;

b) në pikën 2, “Përkufizime”, bëhet një ndryshim dhe një shtesë, si më poshtë vijon:

i. pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. **“Shërbim”** është çdo aktivitet ekonomik vetëpunësimi, i cili normalisht sigurohet për shpërbim, përfshirë aktivitete të karakterit:

- industrial;
- tregtar;
- zejtar;
- të profesionistëve.”;

ii. pas pikës 5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. **“Standard”** është një specifikim teknik, i miratuar nga një organ i njohur standardizimi, për zbatim të përsëritur ose të vazhdueshëm, përputhshmëria me të cilin nuk është e detyrueshme dhe që është një nga përcaktimet e mëposhtme:

a) “Standard ndërkombëtar”, një standard i miratuar nga një organ ndërkombëtar standardizimi;

b) “Standard evropian”, një standard i miratuar nga një organizatë evropiane standardizimi;

c) “Standard i harmonizuar”, një standard evropian i miratuar në bazë të një kërkesë të bërë nga Komisioni Evropian për zbatimin e legjislacionit të harmonizuar të Bashkimit Evropian;

ç) “Standard kombëtar”, një standard i miratuar nga një organ kombëtar standardizimi.”

2. Në kreun II, “Transparenca dhe pjesëmarrja e grupeve të interesit”, bëhet një ndryshim dhe një shtesë, si më poshtë vijon:

a) nën-pika 3.4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3.4 DPS-ja njofton organizatat e tjera të standardizimit në nivel rajonal dhe/ose ndërkombëtar për ekzistencën e programit të punës në përputhje me legjislacionin, rregulloret e brendshme dhe procedurat e saj në fuqi.”;

b) pas nën-pikës 6.1 shtohet nën-pika 6.2, me këtë përmbajtje:

“6.2 Kundërshtitë zyrtare ndaj standardeve të harmonizuara

6.2.1 Kur autoritetet shqiptare, përfshirë DPS-në ose ministrinë përgjegjëse konsiderojnë se një standard shqiptar i harmonizuar nuk përmbush plotësisht kërkesat që synon të mbulojë dhe që përcaktohen në legjislacionin përkatës (rregulloret teknike), Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për çështjet tregtare dhe/ose ekonomike, pas konsultimit me DPS-në, mund të anulojë referencën për këtë standard dhe ta heqë atë nga lista e botuar për standardet e referencës. Procedura do të kryhet në përputhje me detyrimet e autoriteteve shqiptare dhe me legjislacionin, rregulloret e brendshme dhe procedurat e DPS-së në fuqi.”

3. Në kreun IV, “Financimi i standardizimit evropian”, bëhen disa shtesa dhe një ndryshim, si më poshtë vijon:

a) në fund të të shkronjës “a”, të nën-pikës 9.2, shtohen fjalët “... si dhe organizatat evropiane të

¹ Ndryshimet dhe shtesat e propozuara në këtë projektvendim transpozojnë të plotë rregulloren (BE) nr. 1025/2012, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të 25 tetorit 2012, “Për standardizimin evropian”, që ndryshojnë direktivat e Këshillit 89/686/KEE dhe 93/15/KEE dhe direktivat 94/9/KE, 94/25/KE, 95/16/KE, 97/23/KE, 98/34/KE, 2004/22/KE, 2007/23/KE, 2009/23/KE dhe 2009/105/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e shfuqizimin e vendimit të Këshillit 87/95/KEE, dhe vendimin nr. 1673/2006/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.



grupeve të interesit, siç përcaktohen në shtojcën II të vendimit;”;

b) në nënpikën 10.1, fjala “Qeveria ...” zëvendësohet me “Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit ...”;

c) pas nënpikës 10.2 shtohet nënpika 10.3, me këtë përmbajtje:

“10.3 Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dërgon një raport vjetor në organizmat evropianë të standardizimit, në përputhje me detyrimet e autoriteteve shqiptare dhe me legjislacionin, rregulloret e brendshme dhe procedurat e saj në fuqi. Raporti përmban informacione të hollësishme për sa vijon:

a) transparencën e standardeve;

b) pjesëmarrjen e palëve të interesuara në standardizimin shqiptar dhe evropian;

c) financimet nga Bashkimi Evropian;

ç) përfaqësimin e NVM-ve, organizatave të konsumatorëve dhe aktorëve mjedisorë e socialë në organet kombëtare të standardizimit;

d) publikimin në faqen e internetit të DPS-së për lehtësirat e krijuara për NVM-të, për përdorimin e standardeve dhe pjesëmarrjen e tyre në proceset e hartimit e adoptimit të standardeve;

dh) përdorimin e specifikimeve teknike të TIK-ut në sistemin e standardizimit;

e) bashkëpunimin ndërmjet organeve kombëtare të standardizimit dhe organizatave evropiane të standardizimit.”.

ç) pas pikës 10, “Organet kombëtare të standardizimit”, shtohet pika 11, me këtë përmbajtje:

“11. Pjesëmarrja e palëve të interesuara në standardizimin shqiptar dhe evropian

11.1 DPS-ja zbaton qasjen e procedurave të mëposhtme në veprimtarinë kombëtare në fushën e standardizimit dhe bashkëpunon për zbatimin e saj në nivelin rajonal (evropian).

11.2 DPS-ja inkurajon e lehtëson përfaqësimin dhe pjesëmarrjen efektive të të gjithë aktorëve relevantë, përfshirë NVM-të, organizatat e konsumatorëve dhe palët e interesit mjedisor dhe social në aktivitetet e saj të standardizimit. Ajo e realizon këtë veçanërisht përmes organizatave evropiane të interesit, që marrin financime nga Bashkimi Evropian, në përputhje me këtë rregullore në nivelin e zhvillimit të politikave dhe në fazat vijuese të zhvillimit të standardeve

evropiane ose çdo publikim tjetër për standardizimin evropian:

a) propozimin e pranimit e titujve të rinj të punës;

b) diskutimin teknik për propozimet;

c) paraqitjen e komenteve për draftet e përgatitura;

ç) rishikimin e standardeve ekzistuese evropiane ose të publikimeve të tjera të standardizimit evropian;

d) shpërndarjen e informacionit dhe ritjen e ndërgjegjësimit në nivel kombëtar për standardet evropiane të miratuara ose publikimet e standardizimit evropian.

11.3 DPS-ja bashkëpunon me autoritetet e mbikëqyrjes së tregut në rajon, objektet kërkimore të Komisionit Evropian dhe organizatat evropiane të interesit, që marrin financime nga Bashkimi Evropian, në përputhje me këtë rregullore, dhe lehtëson përfaqësimin, në nivelin teknik, të ndërmarrjeve, qendrave kërkimore, universiteteve dhe personave të tjerë juridikë (kur këta të fundit kanë marrë pjesë në projekte të kësaj fushe dhe që është financuar nga Bashkimi Evropian me programe shumëvjeçare në fushën e kërkimit, të inovacionit dhe zhvillimit teknologjik) në aktivitetet e standardizimit lidhur me një fushë në zhvillim me ndikime të rëndësishme teknologjike.”.

4. Kreu V, “Dispozita kalimtare”, riformulohet, si më poshtë vijon:

“Kreu V

DISPOZITA KALIMTARE

12. Periudhat e zbatimit të rregullores

12.1 Me përjashtim të pikës 7, pikat 1 deri në 11 zbatohen me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave, që miraton këtë rregullore.

12.2 Pika 7, e kësaj rregulloreje, zbatohet drejtpërdrejt me anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 675, datë 10.11.2021****PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “PËRMIRËSIMI I
FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM PËR
QYTETIN E ROSKOVECIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin e Roskovecit”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Roskovec.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me një vlerë të përgjithshme prej 971 548.50 (nëntëqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 971 548.50 (nëntëqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Roskovec.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i

përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Bashkisë Roskovec.

8. Bashkia Roskovec kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Roskovec.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Roskovec, fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Roskovec.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Roskovec, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, pranë Këshillit të Qarkut Fier, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “PËRMIRËSIMI I FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM PËR QYTETIN E ROSKOVECIT”

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Nr. i pasurisë	ZK	Sipërfaqja e parcelës, sipas kartelës së pronësisë m ²	Sip. e tokës e prekur m ²	Çmimi, lek/m ²	Vlera e tokës	Lloji i kulturës bujqësore	Vlera e kulturës/dy	Vlera në lek e kulturës	Vlera totale, lek	Shënime sqaruese
1	Defrim Barjam Hoxha	63/36	3767	4,759.00	1,074.00	269	288,906.00	Misër	17,125.00	18,392.25	307,298.25	Certifikatë pronësie
2	Hekuran Bajram Mamo	64/27	3767	3,257.00	1,074.00	269	288,906.00	Misër	17,125.00	18,392.25	307,298.25	Certifikatë pronësie
3	Aqif Caush Hoxha Emine Shaip Hoxha	66/4	3767	5,455.00	1,284.00	269	345,396.00	Tërfil	9,000.00	11,556.00	356,952.00	Certifikatë pronësie
Vlera totale paraprake					3,432.00		923,208.00			48,340.50	971,548.50	

1. Vlerësimi për kulturën bujqësore është kryer bazuar në udhëzimin nr. 1, datë 5.10.2000
2. Vlerësimi i pasurisë së llojit “tokë arë”, është kryer në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.



VENDIM

Nr. 676, datë 10.11.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 699, DATË 5.10.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR ‘BY-PASS
VLORE’ (SHTESA)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 699, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) pikat 3, 4 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, “arë”, “kullotë”, “pyll”, “drurë frutorë” dhe “ullishte”, me një vlerë të përgjithshme prej 254 371 689 (dyqind e pesëdhjetë e katër milionë e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekësh, si më poshtë vijon:

- truall, me sipërfaqe 22 141 (njëzet e dy mijë e njëqind e dyzet e një) m², me vlerë 230 691 978 (dyqind e tridhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë;

- arë, me sipërfaqe 55 316 (pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë) m², me vlerë 11 284 464 (njëmbëdhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë;

- kullotë, me sipërfaqe 19 639 (nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë) m², me vlerë 3 948 628 (tre milionë e nëntëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e tetë) lekë;

Faqe | 15604

- pyll, me sipërfaqe 4 187 (katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë) m², me vlerë 690 855 (gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë;

- drurë frutorë, me vlerë 6 732 500 (gjashtë milionë e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë;

- ullishte, me sipërfaqe 5 016 (pesë mijë e gjashtëmbëdhjetë) m², me vlerë 1 023 264 (një milion e njëzet e tre mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë e llojit “truall”, “arë”, “kullotë”, “pyll” “drurë frutorë” dhe “ullishte”, në shumën 254 371 689 (dyqind e pesëdhjetë e katër milionë e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë, të përballohet, si më poshtë vijon:

- 234 237 718 (dyqind e tridhjetë e katër milionë e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) lekë, nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë;

- 11 589 579 (njëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë, nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

- 8 544 392 (tetë milionë e pesëqind e dyzet e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) lekë, nga fondi i Autoritetit Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 170 000 (njëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen, si më poshtë vijon:

- 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar;

- 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.”;

b) pas tabelave bashkëlidhur vendimit shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, si dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VKM-në NR. 699, DATË 5.10.2016, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘BY-PASS VLORE’”

Nr.	PRONARI	ZK	Nr. i pas.	LLOJI I PASURISË			Sip. totale	VLERËSIMET				VLERA	Shënime
	Emri i pronarit			Arë/vresht	Ullishte	Kullotë		Sip. e vlerësuar	Çmimi	Kultura bujqësore	Vlera për sip. në (lekë)	Totale (lekë)	
1	HAXHI ISA BEGAJ	2074	373/19	arë						14,000		14,000	P. verbal/konf. ASHK.
2	KIMET BATJAR HOXHAJ	2074	887/5		ullishte					270,000		270,000	P. verbal/konf. ASHK.
3	LICO SADIK BESHAI	2074	727/3		ullishte					158,000		158,000	P. verbal/konf. ASHK.
4	VIKTOR BESHAI	2074	152/6		ullishte					252,000		252,000	P. verbal/konf. ASHK.
5	VIKTOR BESHAI	2074	160/17		ullishte								P. verbal/konf. ASHK.
6	KAstriOT BATJAR HOXHAJ	2074	887/1		ullishte					555,000		555,000	P. verbal/konf. ASHK.
7	HAMZA NAMIK DERAJ	2074	161	arë						548,000		548,000	P. verbal/konf. ASHK.
8	FASLLI HIQMET LAZAJ	2074	564/9/2		ullishte					420,000		420,000	P. verbal/konf. ASHK.
9	ADHURIM HAMZA DERAJ	2074	941/2		ullishte					414,000		414,000	P. verbal/konf. ASHK.
10	AVDUL METUSHAJ	2074	160/15		ullishte					115,500		115,500	P. verbal/konf. ASHK.
11	IMER MERKAJ	2074	160/11		ullishte					154,000		154,000	P. verbal/konf. ASHK.
12	XHEMIL HAMZAJ	2074	152/4		ullishte					344,000		344,000	P. verbal/konf. ASHK.
13	NIAZI ISUF HASANAJ	2074	160/8		ullishte					224,000		224,000	P. verbal/konf. ASHK.
14	BP FEJZAJ, BELAJ, TOZAJ	2074	553/6		ullishte					76,000		76,000	P. verbal/konf. ASHK.
15	QIRJAKO NOÇKA	8605	56/92		ullishte					768,000		768,000	P. verbal/konf. ASHK.
16	BP RISILIA, BUDO,SHEHAJ	1061	76			kullotë				1,620,000		1,620,000	P. verbal.
17	BP RISILIA, BUDO,SHEHAJ	1061	81			kullotë							P. verbal.
18	BP RISILIA, BUDO,SHEHAJ	1061	87+88			kullotë							P. verbal.
19	BP RISILIA, BUDO,SHEHAJ	1061	76			kullotë	25490	4156	200		831,200	831,200	Konf. nga ASHK-ja.
20	BP RISILIA, BUDO,SHEHAJ	1061	81			kullotë	3600	562	200		112,400	112,400	Konf. nga ASHK-ja.
21	BP RISILIA, BUDO,SHEHAJ	1061	87+88			kullotë	8070	2613	200		522,600	522,600	Konf. nga ASHK-ja.
22	FEJZI PREMTAJ	2074	160/23		ullishte		2820	850	204		173,400	173,400	Konf. nga ASHK-ja.
23	AZEM SELMANAJ	3401	115/2			kullotë	1700	508	241		122,428	122,428	Konf. nga ASHK-ja.
24	KIMET BATJAR HOXHAJ	2074	887/1/1		ullishte		1330	550	204		112,200	112,200	Konf. nga ASHK-ja.
25	QIRJAKO NOÇKA	8605	56/92		ullishte		14000	2781	204		567,324	567,324	Konf. nga ASHK-ja.
26	ADHURIM DERAJ	2074	941/2		ullishte		1370	835	204		170,340	170,340	Konf. nga ASHK-ja.
	Totali										2,611,892	8,544,392	

**VENDIM****Nr. 677, datë 10.11.2021**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 600, DATË 18.10.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT ‘RIKUALIFIKIMI URBAN I
SHËTITORES ‘REPUBLIKA’, PATOS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 600, datë 18.10.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

a) të dhënat e nr. rendor 2, të tabelës bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me të dhënat sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Bashkinë Patos.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Patos, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama**

**LISTA EMËRORE E PRONARIT TË PASURISË, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA
NDRYSHIMI I VKM-së NR. 600, DATË 18.10.2017, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTT ‘RIKUALIFIKIMI URBAN I SHËTTTORES
‘REPUBLIKA’ PATOS”**

Ndryshimi i VKM-së nr. 600, datë 18.10.2017												
Nr. rendor	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e përgj. e truallit m ²	Sip. e prekur e truallit në m ²	Çmimi për truall (lekë/m ²)	Vlera e truallit	Sip. e ndërtesës me certifikatë (m ²)	Sip. e prekur e ndërtesës (m ²)	Vlera e ndërtesës	Vlera e përgjithshme (lekë)	Shënime
2	LULËZIME SHEME RAPUSHAJ	2890	10/106-N1	21	21	2,848.00	59,808.00	42	42	1,031,310.76	1,091,118.76	Certifikatë pronësie

**VENDIM****Nr. 678, datë 10.11.2021****PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT TË
ARSIMIT TË LARTË, JOPUBLIK,
KOLEGJI PROFESIONAL I LARTË
GJERMAN I TEKNOLOGJISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, 30 e 31, pika 1, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e institucionit të arsimit të lartë, jopublik, Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë, në emër të shoqërisë “Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë” sh.p.k., i cili e ushtron veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë organizohet në 3 (tre) departamente, si më poshtë vijon:

- a) Departamenti i Mekanikës;
- b) Departamenti Elektrik dhe i Teknologjisë së Informacionit;
- c) Departamenti i Ndërtimit dhe Infrastrukturës.

3. Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë ofron programe të studimit sipas kuadrit ligjor në fuqi.

4. Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë e fillon veprimtarinë e tij vetëm pas nxjerrjes së urdhrit të ministrit përgjegjës për arsimin për fillimin e veprimtarisë.

5. Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional e të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

6. Statuti i institucionit të arsimit të lartë, jopublik, Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë, miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

7. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontroll periodik të ligjshmërisë në institucion, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe shoqëria “Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 679, datë 10.11.2021****PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT TË
ARSIMIT TË LARTË, JOPUBLIK,
UNIVERSITETI “WESTERN BALKANS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18, 30 e 31, pika 1, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e institucionit të arsimit të lartë, jopublik, universiteti “Western Balkans” (në vijim, universiteti “Western Balkans”), në emër të shoqërisë “Western Balkans University” sh.p.k., i cili ushtron veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Universiteti “Western Balkans” organizohet në 3 (tri) fakultete:

- a) Fakulteti i Mjekësisë Dentare;
- b) Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;
- c) Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit.

3. Universiteti “Western Balkans” mund të ofrojë programe studimi në të gjitha ciklet e studimeve të arsimit të lartë, si edhe programe studimi me karakter profesional, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

4. Universiteti “Western Balkans” e fillon veprimtarinë e tij vetëm pas nxjerrjes së urdhrit të ministrit përgjegjës për arsimin për fillimin e veprimtarisë akademike.

5. Universiteti “Western Balkans” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional e të programeve të studimit brenda afateve të



përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

6. Statuti i universitetit “*Western Balkans*” miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

7. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontroll periodik të ligjshmërisë në institucion, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

8. Çdo ndryshim i njësive kryesore të universitetit “*Western Balkans*” miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, sipas legjislacionit në fuqi.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe shoqëria “*Western Balkans University*” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 680, datë 10.11.2021

**PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË
FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT TË
ETIKËS MJEKËSORE PËR PAJISJET
MJEKËSORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4/1, të nenit 11, të ligjit nr. 89/2014, “Për pajisjet mjekësore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky vendim përcakton kriteret për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore, si dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të tij.

**II. ORGANIZIMI I KOMITETIT TË
ETIKËS MJEKËSORE PËR PAJISJET
MJEKËSORE**

1. Komiteti i Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore është organ i pavarur, i përbërë nga profesionistë të shëndetit ose jo, me qëllim mbrojtjen e të drejtave, të sigurisë e të mirëqenies së personave të përfshirë në provat klinike të

pajisjeve mjekësore dhe sigurojnë garanci publike të mbrojtjes së të drejtave, nëpërmjet shprehjes së opinionit në protokolle të provave klinike, përshtatshmërinë e investuesve, metodave dhe dokumentacionit të përdorur.

2. Komiteti i Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore ka në përbërje 7 (shtatë) anëtarë, si më poshtë vijon:

- a) 2 (dy) inxhinierë elektronikë / elektrikë / biomjekësorë;
- b) 1 (një) farmacist;
- c) 1 (një) mjek specialist;
- ç) 1 (një) jurist;
- d) 1 (një) personalitet në fushën e shëndetësisë;
- dh) 1 (një) psikolog.

3. Anëtarët e Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore e ushtrojnë këtë funksion për një mandat trevjeçar, me të drejtë përsëritjeje jo më shumë se 2 (dy) herë radhazi.

4. Anëtarët e Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore emërohen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë pas plotësimit të kriterëve në pikën 5, të këtij vendimi.

5. Anëtarët e Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore plotësojnë këto kriterë:

- a) të jenë shtetas shqiptarë;
- b) të kenë njohuritë e nevojshme, të dokumentuara në fushën që ata përfaqësojnë;
- c) të kenë njohuritë e nevojshme dhe përvojë, të dokumentuara në fushën e pajisjeve mjekësore;
- ç) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- d) të mos kenë qenë të dënuar më parë me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

6. Komiteti i Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore zgjedh kryetarin e zëvendëskryetarin.

7. Kryetari dhe zëvendëskryetari i Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore zgjidhen me votim të fshehtë, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve.

8. Kryetari i Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore e ushtron këtë funksion me mandat trevjeçar dhe nuk mund ta kryejë këtë detyrë për më shumë se 2 (dy) mandate të njëpasnjëshme.

9. Mbledhja për zgjedhjen e kryetarit drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë.



10. Anëtarët e Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore shprehin interesin për t'u zgjedhur si kryetar apo zëvendëskryetar në mbledhjen e parë. Drejtuesi i mbledhjes garanton kohë të mjaftueshme dhe të barabartë për prezantimin e anëtarëve që kanë shprehur interesin.

11. Në rast se ka më shumë se një kandidat dhe gjatë votimit asnjëri prej tyre nuk merr shumicën e parashikuar të votave, bëhet një votim i ri dhe, pas këtij, vijohet me votimin mes kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave. Në përfundim të këtij votimi shpallet i zgjedhur kandidati që ka marrë shumicën e votave. Në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka marrë shumicën e votave ose votat janë ndarë në mënyrë të barabartë, kryetari caktohet me short.

12. Kryetari i zgjedhur njofton ministrin përgjegjës për shëndetësinë.

13. Anëtarët e Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore ushtrojnë veprimtarinë e tyre kundrejt shpërblimit. Masa e shpërblimit për kryetarin dhe anëtarët përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve.

III. FUNKSIONIMI DHE VEPRIMTARIA E KOMITETIT TË ETIKËS MJEKËSORE PËR PAJISJET MJEKËSORE

1. Komiteti i Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) mbron të drejtat, sigurinë dhe mirëqenien e personave të përfshirë në provat klinike të pajisjeve mjekësore;

b) siguron garanci publike të mbrojtjes së të drejtave nëpërmjet shprehjes së opinionit në protokolle të provave klinike;

c) siguron përshtatshmërinë e investiguesve, metodave dhe dokumentacionit të përdorur;

ç) harton udhëzuesin për kryerjen e provave klinike të pajisjeve mjekësore dhe vlerësimin e vazhdueshëm të ecurisë, efikasitetit dhe efekteve anësore në shëndetin e pacientit dhe e paraqet atë për miratim te ministri përgjegjës për shëndetësinë. Udhëzuesi publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;

d) bën publike mënyrën e vlerësimit e të marrjes së vendimeve, si dhe kuorumin e nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjeve të tij;

dh) miraton rregullat e sjelljes së anëtarëve të tij.

2. Kryetari i Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore ushtron këto funksione:

a) përgatit, thërret dhe drejton mbledhjet e Komitetit;

b) përfaqëson Komitetin e Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore në marrëdhënie me të tretët;

c) siguron mbështetjen administrative, organizative dhe financiare të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë për funksionimin e Komitetit;

ç) siguron dokumentacionin e mbledhjes së Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore dhe mbajtjen e dokumentacionit, në përputhje me legjislacionin për arkivat;

d) nënshkruan vendimet dhe çdo akt tjetër, që lidhet me ushtrimin e kompetencave të Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore, dhe shkresat e ndryshme për komunikimin e Komitetit me të tretët;

dh) ushtron çdo detyrë tjetër të përcaktuar nga mbledhja e Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore.

3. Në pamundësi objektive a pengesë ligjore të kryetarit, këto funksione ushtrohen nga zëvendëskryetari.

4. Përcaktimi i çështjeve të rendit të ditës dhe caktimi i ditës së zhvillimit të mbledhjes së Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore bëhet nga kryetari, duke mbajtur parasysh mendimin e anëtarëve. Në rendin e ditës përfshihen edhe çështjet që mund të propozohen me shkrim nga secili prej anëtarëve të tjerë të Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore. Nëse dita e mbledhjes së Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore është paracaktuar në mbledhjen paraardhëse, njoftimi i anëtarit për çështje që duhet të përfshihen në rendin e ditës duhet të paraqitet jo më vonë se 3 (tre) ditë nga ajo e caktuar për zhvillimin e mbledhjes.

5. Komiteti i Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore mbledhet sa herë është i nevojshëm shqyrtimi i një çështjeje ose rasti, por jo më pak se 1 (një) herë në 3 (tre) muaj.

6. Mbledhja paraardhëse e Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore, përpara përfundimit të saj, diskuton e vendos, nëse e



vlerëson të nevojshme, për rendin e ditës, ditën dhe kohën e zhvillimit të mbledhjes pasardhëse.

7. Nëse nuk është vendosur ndryshe, nga mbledhja e mëparshme e Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore, mbi bazën e punës përgatitore dhe të propozimeve të tjera të anëtarëve, kryetari thërret mbledhjen e vendos rendin e ditës, datën dhe kohën e zhvillimit të saj.

8. Në pamundësi objektive, papajtueshmëri, konflikt interesi ose pengesë ligjore të kryetarit, veprimet përgatitore dhe thirrja e mbledhjes kryhen nga zëvendëskryetari.

9. Anëtarët e Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore nuk duhet të kenë konflikt interesi për çdo vendim që duhet të marrin dhe duhet të nënshkruajnë një deklaratë vjetore, nëpërmjet së cilës ata bien dakord për të mos u shprehur mbi ato prova klinike, për të cilat mund të jenë në konflikt interesi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

10. Kuorumi i nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjeve të Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore, në çdo rast, duhet të jetë më shumë se gjysma e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e të pranishmëve me të drejtë vote. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.

11. Komiteti i Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, ndihmohet nga një sekretariat teknik, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, i caktuar nga vetë Komiteti i Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore. Sekretariati teknik ka këto detyra:

a) të administrojë të gjitha kërkesat drejtuar Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore;

b) të mbajë procesverbalet e çdo mbledhjeje të Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore.

12. Anëtarët e Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore dhe stafi i sekretariatit teknik kanë detyrimin të respektojnë parimin e konfidencialitetit dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale edhe pas lënies së mandatit apo largimit nga detyra.

13. Në veprimtarinë e tij, Komiteti i Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore udhëhiqet nga parimet që rrjedhin nga Deklarata e Helsinkit, Konventa e Oviedos, standardet e praktikës së mirë klinike dhe udhëzimet e përditësuara të Agjencisë Evropiane për Vlerësimin e Produkteve Mjekësore. Të drejtat, siguria dhe mirëqenia e personave të përfshirë në provat klinike mbizotërojnë mbi interesat e shkencës dhe të shoqërisë.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ministri përgjegjës për shëndetësinë thërret mbledhjen e parë të Komitetit të Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore.

2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për shëndetësinë për zbatimin e ndjekjen e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë